

# Të votuarit

E diel, më 26 maj 2019  
janë zgjedhjet për Parlamentin Evropian.

Val 26 maj 2019  
EUROPAPARLAMENTET

## Kush ka të drejtë votimi?

Ti ke të drejtë votimi nëse je shtetas suedez dhe je apo ka qenë rezident në Suedi. Ti ke të drejtë votimi edhe po ashtu nëse je shtetas i ndonjëres nga shtetet anëtare të BE-së, je rezident në Suedi dhe je paraqitur në listën e votuesve. Ti duhet të jesh 18 vjeç, sëpaku në ditën e zgjedhjeve.

## Ti që ke të drejtë votimi do e marrësh një kartë votimi

Ti që ke të drejtë votimi e merr një kartë votimi me postë sëpaku tri javë para zgjedhjeve. Në atë kartë shkruan emri, adresa dhe orari i votimit në qendrën tuaj të votimit. Aty gjen edhe shembuj se në cilat lokale mund të votosh para kohe. Nëse të mungon karta e votimit mund të porositësh një kartë të re nga komuna apo Autoriteti i Zgjedhjeve.



## Fletëvotime

Fletëvotimet gjenden në të gjitha lokalet ku mbahen zgjedhjet dhe tek partitë.

## Voto për një parti

Në radhë të parë ti voton për një parti. Emri i partisë shkruan në fletëvotim. Nëse nuk e gjen fletëvotimin e partisë tuaj, ti mund ta shkruash emrin e partisë në një fletëvotim të zbrazët. Shkruaj qartë.

## Votimi për person

Nëse dëshiron që një kandidat i caktuar i partisë të zgjedhet, ti mund të vësh një iks para emrit të kandidatit në fletëvotim. Ti mund të vësh iks vetëm për një kandidat. Ti mund të votosh për një person duke e shkruar emrin e partisë dhe të kandidatit në një fletëvotim të zbrazët.

## Votimi

### Voto në qendrën tuaj të votimit në ditën e zgjedhjeve më 26 maj

Ti mund të votosh vetëm në atë qendër votimi që shkruan në kartën tuaj të votimit. Qendra e votimit është hapur vetëm në ditën e zgjedhjeve. Kur ti voton në qendrën e votimit kjo evidentohet në listën e votuesve dhe vota e juaj futet në kuti.

### Votimi i parakohshëm në komunën tuaj apo në ndonjë komunë tjetër

Ti mund të votosh para kohe në çdo qendër votimi në vend. Votimi i parakohshëm fillon diku rreth tri javë para ditës së zgjedhjeve dhe vazhdon deri në ditën e zgjedhjeve. Informacionin se kund mund të votosh para kohe e gjen në komunën tuaj ose në [www.val.se](http://www.val.se).

Ti duhet ta kesh me vete kartën e votimit kur voton para kohe.



## Voto nga jashtë

Nëse je jashtë shtetit ti mund të votosh përmes letrës apo votimit në njërën nga ambasadat dhe konsulatat e shumta të Suedisë. Për të votuar përmes letrës duhet të përdoret një material i posaçëm që ti e porosit në Autoritetin Zgjedhjeve, komuna, ambasada apo konsulata.

## Ndihmë për të votuar

### Votim përmes përfaqësuesit

Nëse ti për shkak të sëmundjes, aftësive të kufizuara apo moshës nuk mund të shkosh në qendrën e votimit atëherë mund të votosh përmes përfaqësuesit. Ti mund të votosh përmes përfaqësuesit nëse je i paraburgosur apo në burg. Për të votuar përmes përfaqësuesit duhet të përdoret një material i posaçëm që ti e porosit nga komuna apo Autoriteti i Zgjedhjeve.

Këta persona mund të jenë përfaqësues:

- burri, gruaja apo bashkëjetuesi
- fëmijët, nipat/mbesat, prindërit, vllazërit/motrat e burrit, gruas, bashkëjetuesit
- ata që e kanë për profesion trajtimin tuaj apo që të ndihmojnë me çështje personale
- punëtorët e paraburgut apo burgut.

Përfaqësusi duhet të jetë sëpaku 18 vjet dhe të posedoj dokument identiteti.

### Pranues ambulator i votave

Nëse ti nuk njeh askë që mund të jetë përfaqësues i yt, komuna e juaj mund ta rregulloj një pranues i votave i cili vjen në shtëpinë tuaj. Kontaktoje komunën tuaj për më shumë informacione.

## Ti duhet t'a vërtetosh identiten tuaj

Për të votuar ti duhet ta vërtetosh identiten tuaj. Nëse pranuesi i votës nuk të njeh, ti duhet të tregosh një dokument identiteti, psh. patentën e shoferit apo pasaportën. Nëse të mungon dokumenti i identitetit atëherë një person tjetër mund ta vërtetoj identin tuaj, por ai person duhet të ketë dokument identiteti.

## Kalendari për zgjedhjet e BE-së 2019

<b>11 april</b>	Data më e herëshme kur mund të postosh letrën e votimit nga jashtë.
<b>26 april</b>	E dreja e votimi përcaktohet nga të dhënat në zyrën civile të Entit Tatimor.
<b>2 maj</b>	Data më e herëshme kur mund të votosh në ambasada apo konsulata suedeze.
<b>8 maj</b>	Votimi i parakohshëm fillon në Suedi.
<b>26 maj</b>	Dita e zgjedhjeve.